



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1820/Prot.
3

Tiranë, më 27. 8.2024

V E N D I M

Nr. 21, datë 27. 8.2024

PËR

**“PAJISJEN E SIPËRMARRËSIT VODAFONE ALBANIA SH.A ME AUTORIZIM
INDIVIDUAL PËR PËRDORIM FREKUENCASH NË BREZIN 3400-3800 MHZ (3680-
3780 MHZ), SASI SPEKTRI 100 MHZ, PËR KËRKIM, MATJE DHE PROVË”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 27.08.2024, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Funkzionimit të Këshillit Drejtues të AKEP miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Grupit të Punës, shqyrtoi kërkesën me objekt:

- *Pajisjen me Autorizim Individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a për përdorim frekuencash në brezin 3400-3800 MHz (3680-3780 MHz), sasi spektri 100 MHz, për kërkim, matje dhe provë.*

BAZA LIGJORE:

1. Germat g) dhe gj), të nenit 8, nenet 66, 67, 70, 71 dhe 72 të Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, (**ligji 9918/2008**);

2. Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
3. VKM nr. 1187 datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (PKF).
4. Planin e Përdorimit të Frekuencave (PPF), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 7 datë 06.09.2023.
5. VKM nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe të planit të veprimit”.
6. Rregullore nr. 30, datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”;
7. Rregullore e brendshme e Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të KD të AKEP, e ndryshuar.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor i përbërë si më poshtë:

1. Aplikimi i sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, për përdorim frekuencash në brezin 3400-3800 MHz (3680-3780 MHz), sasi spektri 100 MHz, për kërkim, matje dhe provë;
2. Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;

VËREN:

1. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, në datën 14.08.2024 (nr. 1820 prot., datë 15.08.2024), ka paraqitur në modulën e aplikimeve online, aplikim për caktim dhe përdorim frekuencash në brezin 3400-3800 MHz (3680-3780 MHz), sasi spektri 100 MHz, për kërkim, matje dhe provë.
2. Referuar aplikimit të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, kërkesa teknike e sipërmarrësit përmbledhet si më poshtë:
 - Numri total i stacioneve (BTS): 40
Këto stacione do të instalohen në disa rrugë dhe objekte me densitet të lartë popullsie në Tiranë dhe një nga këta stacione do të instalohet në Aeroportin e Rinasit. Në formularë janë paraqitur edhe vendndodhjet e sakta me kordinata, të vendeve ku do të instalohen secili prej stacioneve.
 - Frekuencat e kërkuara:
Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a ka aplikuar për caktim dhe përdorim të frekuencave të brezit 3400-3800 MHz (3680-3780 MHz), sasi spektri 100 MHz, spektër i paçiftuar, për kërkim, matje dhe provë.
 - Qëllimi i përdorimit të sistemit:
Vodafone Albania sh.a në aplikimin e tij kërkon caktimin e këtyre frekuencave për kërkim, matje dhe provë, me synimin:
 - Testim i teknologjisë 5G New Radio.
 - Testim teknik i Massive MIMO (shumë hyrje - shumë dalje).
 - Testim i shpejtësive, mbulimit dhe vonesave.

- Teknologjia që do të perdoret: Nokia.
 - Afati i kërkuar nga Vodafone Albania sh.a:
1 muaj (nga data 20 shtator deri në datën 20 tetor).
3. Aplikimet e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a për përdorim frekuencash në brezin 3400-3800 MHz për qëllime studimi, kërkimi, provë dhe eksperimentimi, janë paraqitur në formën e kërkuar të përcaktuar në Rregulloren nr. 30 datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”.
 4. Aplikimi i sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, gjendet në përputhje me:
 - Pikën 3, të nenit 72, të Ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: AKEP lëshon autorizime individuale për përdorimin e frekuencave për qëllime kërkimi, matjeje dhe prove të pajisjeve të radiokomunikimit për një zonë të kufizuar mbulimi dhe për një periudhë kohore jo më shumë se 90 ditë.
 - Pikën 3, të nenit 6 të Rregullosës nr. 30 për “Dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”.
 - Përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave (tabelat faqe 66 dhe 67).
 - Përcaktimet e Planit të Përdorimit të Frekuencave (kapitulli 3, faqet 106-109).
 5. Aplikimi i sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a, është paraqitur për një periudhë 1 mujore (nga data 20.09.2024 deri në datën 20.10.2024, pra është brenda periudhës 3 mujore të përcaktuar në pikën 3, të nenit 72, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar.
 6. Referuar eksperiencave të mëparshme, rezulton se ky brez frekuencash është testuar nga sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a në vitin 2019 (sipas Autorizimit Individual miratuar me VKD nr. 34, datë 14.10.2019), në sasi spektri 100 MHz, për 3 stacione (BTS), për një periudhë 2 mujore.
 7. Dokumentet e paraqitura për miratim, janë në përputhje me përcaktimet germave g) dhe gj), të nenit 8 dhe nenet 66, 67, 70, 71 dhe 72 të Ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikës gj), të nenit 8, pikës 1, të nenit 115 të Ligjit nr. 9918/2008, pikës 1 të nenit 9, të ligjit nr. 34/2017 K.Pr.A dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, duke çmuar rëndësinë e vijimit të procesit, interesin publik dhe përputhshmërinë ligjore, Këshilli Drejtues i AKEP;

V E N D O S I:

1. Të pajisë sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz (3680-3780 MHz), sasi spektri 100 MHz, për kërkim, matje dhe provë, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Afati për përdorimin e këtyre frekuencave nga sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, është nga data 20.09.2024 deri në datën 20.10.2024.
3. Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, me mbarimin e afatit të vlefshmërisë, duhet të njoftojë AKEP për përfundimin e përdorimit të këtyre frekuencave dhe rezultatet e testimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Tomi Frashëri



Anëtar

Lorenc Bako



Anëtar

Bleron Dokle



Anëtar

Armer Juka

